



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Data: 30.09.2019

Njoftim

Nga 1 Tetori 2019 barna me recetë – për çdo ditë gjatë muajit

Nga nesër, 1 Tetor 2019, të siguruarit do mund të furnizohen me barna me recetë për çdo ditë gjatë muajit, në cilëndo barnatore që ka marrëveshje me Fondin.

Heqja e kuotave të barnave nëpër barnatore dhe zbatimi i sistemit të rij elektronik për marrjen e barnave, paraqet përfitim të shumfishtë për të gjithë qytetarët, pacientët, mjekët dhe punonjësit mjekësor. Kjo mënyrë e re e përshkrimit dhe marrjes së barnave është vlerë gjithëpërfshirëse në interes të të gjithëve.

Disa nga këto përfitime janë:

- Qytetarët, mvarësisht nevojave të tyre shëndetësore do mund të furnizohen me barna nga cilado barnatore që ka marrëveshje me Fondin, për çdo ditë dhe në çdo kohë, pa dallim nëse është fillimi apo fundi i muajit.
- Qytetarët nuk do të kenë nevojë të grumbullojnë sasi të tepruar të barnave në shtëpi pasi tash do mund të furnizohen me to, në çdo moment kur të kenë nevojë.
- Do të eliminohet rradha e pritjeve nëpër ordinancat e mjekëve dhe nëpër barnatoret, që si zakonisht bëhet ditëve të para të muajit shkaku i përshkrimit të recetave. Kjo nënkupton kushte më të mira pune dhe atmosferë më relaksuese për mjekët, farmaceutët dhe pacientët.
- Do të ulet kërkesa për refundimin e mjeteve për barnat e blera privat nga lista pozitive. Kjo nënkupton se do të evitohet pritshmëria e refundimit të mjeteve për pacientët dhe njëkohësisht do të ulet ngarkesa administrative e punonjësve të Fondit.
- Sistemi i rij elektronik do të mundësojë të drejta të barabarta pune për të gjitha barnatoret. Do të eliminohet favorizimi ose parandalimi i konkurrencës gjatë distribuimit të barnave.



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

- Konsumi i barnave do të racionalizohet. Puna administrative e Fondit do të jetë më efikase. Fondi dhe qytetarët në kohë reale do të kenë pasqyrë të qartë për mangësitë eventuale ose vonesat gjatë distribuimit të barnave.
- Duke u legjitimuar gjatë procesit të blerjes së barnave (me letër njoftimi ose pasaportë), qytetarët japin kontributin e tyre dhe e realizojnë të drejtën ligjore sa i përket përgjegjësisë dhe shpenzimeve të mjeteve që i ndajnë për sigurim shëndetësor. Me këtë duam t'ju kumtojmë se personat e moshuar nuk duhet të brengosen me idenë se mund të ngelen pa barin e nevojshëm. Njëashtu fëmijët dhe personat që nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe fizikisht nuk mundet t'a marrin barin nga barnatorja, e kemi paraparë mundësinë që personi i afërt i tyre të kryejë shërbim në emër të tyre dhe të furnizohet me barin e nevojshëm.

Nëse ndodh që ndonjë barnatore mos t'a ketë barin e përshkruar, personi i siguruar mund t'a paraqesë rastin tek Fondi për sigurim shëndetësor dhe tek Agjencioni për barna dhe paisje medicinale.